

VENDIM
Nr. 567, datë 15.7.2026

PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR, TË NIVELIT TË ARSIMIT TË MESËM TË ULËT, MEDRESEJA “H. MUSTAFA VAROSHI”, KU ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar, të nivelit të arsimit të mesëm të ulët, Medreseja “H. Mustafa Varoshi”, me kohë të plotë, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare dhe ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Institucioni arsimor privat parauniversitar ushtron veprimtarinë arsimore në adresën: Lagjja nr. 13, Rruga e Shqipeve, Durrës.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Durrës dhe institucioni arsimor privat parauniversitar, i nivelit të arsimit të mesëm të ulët, Medreseja “H. Mustafa Varoshi”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama